



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Istogut
Opština Istok
Istog Municipality

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi
RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2025

Raporti është hartuar bazuar në procesverbalet nga mbledhjet e KKSBB-së për periudhën raportuese.
Paraqitur nëmbledhjen e Kuvëndit Komunal me datë 30.03.2026

Nr	Emri i iniciativës/projektit	Përshkrimi i iniciativës/projektit	Raporti mbi realizimin e iniciativës/ projektit
1	Problemet e infrastruktures që ndikojn në siguri, në zonat urbane të minoriteteve	Të ftohen në bashkëbisedim Drejtorati i Urbanizmit dhe i Sherbimeve Publike	Rasim Mahmutoviq, Shef i ZLKB-së- ZLKB-ja punon sipas planit të kontakteve me përfaqësuesit e komuniteteve. Bazuar në të dhënat nga përfaqësuesit e komuniteteve situata e përgjithshme është e qet dhe stabile me disa probleme që koh pas kohe i shqetsojnë qytetarët por që nuk ndikojn në situatën e përgjithshme të sigurisë së komuniteteve. Shqetsimi kryesor që ka qenë në kohët e më hershme viedhjet qoftë të objekteve të banimit apo kafshëve në komunitete, tani së fundmi nuk janë shqetsim, me që ka përmirësime të dukshme. Kërkesat e komuniteteve të cilat mund të ndikojn pozitivisht në sigurinë e komuniteteve e që kanë të bëjnë me projekte janë: -Ndertimi i trotuarit dhe ndriçimit publik në Rr. Sarajevska si dhe shenjat horizontale, gjegjësisht pengesat horizontale në rrugë. -Rregullimi i rruges Serbobran-Osojan e cila ka gropa të mëdha dhe thuajse është e pa kalueshme -Deponit e mbeturinave në Llukavc të Begut
2	Mbrojtja e pyjeve nga zjarret	Të ftohen në bashkëbisedim nga	Haki Belaj, inspektor i parandalimit - me që jemi para një sezoni që do të jetë tejet e nxehtë dhe me mungesë të të reshurave atmosferike, duhet të jemi

-Mirrmbajtja e rrugve malore

Ministria e Bujqësis, Drejtorati i Bujqësis Inspektori i Preventives AME

tejet pergjegjes gjithë qytetaret e Komunes në ndermarjen e masave preventive per parandalimin e zjarreve dhe ti zbatojm udhizimet per mos ndezjen e zjarreve në hapsira. Sa ju perket institucioneve duhet që ti kryejm të gjith detyrimet dhe më lejoni të theksoj se Agjencioni i Pyjeve e ka detyr parsore si menaxhimin poashtu edhe mbrojtjen qoft nga prerjet poashtu edhe nga zjarret, ndersa ne si NJPZSH jemi mbeshtetës në mbrojtjen e pyjeve nga zjarret. Ne e kemi bër një shkres zyrtare Agjencionit për masat të cilat duhet ti ndermarrin në mbrojtjen e Pyjeve nga zjarri dhe njëkohisht i kemi informuar me kapacitetet e limituara si në teknik poashtu edhe në personel. Tani do hyjm edhe në fazen e fushates së korrjeshirjes e cila do të jet mjaft sfiduese në këto temperatura, andaj ftoj që të gjithë që ti zbatojn kompetencat e veta dhe të jen të ndergjegjshëm në zbatimin e tyre. Shfrytzoj rastin që të bëj apel tek bujqit dhe tek Drejtoria e Bujqësisë që fushat e korrura të lavrohen menjëhere për ti evituar zjarret fushore dhe perhapjen e tyre duke rrezikuar edhe objekte banimi etj.

Rifat Dreshaj, Agjencioni i Pyjeve të Kosovës – si Agjencion i kemi bër pergatitjet për mbrojtje nga zjarret dhe per momentin nuk kemi këso problemesh, ballafaqehemi me prerjet ilegale por edhe këto kanë rënje të dukshme.

Astrit Hajrizaj, Drejtor i Drejtoratit të Bujqësis – sa i perket mirëmbajtjes së rrugve malore jemi per momentin duke punuar në tri akse rrugore, të cilat perpos krijimit të kushteve të mira për fermer dhe vizitor të bjeshkëve krijojn edhe kushte optimale në aspektin e sigurtis duke ju ofruar kushte qarkullimi si Policisë, KFOR-it dhe në raste emergjente qoftë zjarrëfikësve qoft autoambulancave. Në të kaluaren sa ka qen sektori i Pylltaris në kuader të Drejtoratit kemi pas bashkëpunim të mirë me zjarrëfikës, Polici dhe institucione tjera dhe shpresoj se edhe tani në kuader të pergjegjsive tona të vazhdojm bashkëpunimin e mirë. Sa i perket korrjeshirjeve kemi formuar shtabin dhe pergatitjet lidhur me këtë fushat.

Zenun Bujupaj, Komuniteti Shqipëtar – a ka ndonjë struktur e veçant në Komunë e cila është pergjegjëse që merret me planifikimin dhe masat e parapara për parandalimin e zjarreve. Ndersa sa i perket rrugve malore çka nënkuptojm me termin rrug malore a janë vetëm ato kah qarkullojn

automjetet apo edhe rrugët kah levizin këmbësorët apo turistët sepse të njëjtat pothuajse janë mbyllë, a janë të perfhira edhe këto për hapjen e tyre.

Skender Hasangjekaj, Sektori i Emergjencave-Koordinator i KKSB-së

– Në kuader të Administrates komunale funksionon Drejtoria për Emergjencë, Mbrojtje dhe Shpëtim, e cila bazon në Legjislacionin për menaxhimin e fatkeqsive natyrore është përgjegjëse për planin e Vlersimit të rrezikut dhe hartimin e Planit Operativ Emergjent, ku perfatqësi të ndryshme parashihen institucionet bartëse dhe institucionet mbështetse. Nga referimet e zyrtarve ju patet mundsi ta vërejni se sa ju perket zjarreve i kemi tri institucione që reagojnë por u tha kush është bartësi i përgjegjësisë. Kur sektori i Pylltarisë ishte pjesë e Drejtoratit të Bujqësisë, Nga niveli qendror gjegjësisht nga Ministria e Bujqësisë për tërë territorin e Kosovës i prononte një numër Zjarrëfikësish, në Istog kanë qenë kater, si vrojtues të pyjeve për të kryer detyren e parandalimit dhe lajtmimit të hershëm në raste zjarresh. Sa i perket NJPZSH-së në Istog janë nën menaxhimin e Drejtorisë por janë staf i AME-së dhe kapacitetet janë të limituara si në personel (10 zjarrëfikës) poashtu edhe në teknik. Pa marrëparasysh Ligjin për vetqeverisje Lokale dhe legjislacionin në fuqi ku parashihen shumë obligime gjegjësisht detyrime të Komunave, niveli Qendror çdo ditë e më shumë është duke i marrë kompetencat por që legjislacioni mbetet i njëjt si detyrime të Komunave. Ligji i fatkeqsive natyrore e obligon çdo qytetar të ndermeri masat për mbrojtje nga fatkeqsit natyrore dhe fatkeqsit tjera. Dalja e turistve apo qytetarve për piknik në bjeshkë duhet menaxhuar ku dhe si dhezin zjarrmije dhe këtë do të duhej ta rregulloj dhe ta përciell Agjencioni i Pylltarisë si përgjegjëse për Pyjet dhe bartse e reagimit eventual në zjarre malore, andaj nese nuk e kanë bërë deri me tani do të duhej të marrin masa për senzibilizimin e opinjonit dhe parandalimin e ndezjes së zjarreve në vende të hapura. Gjitha parashikimet hidrometeorologjike janë që ky vit do të jetë tejet i nxehtë dhe i thatë andaj rreziku nga zjarret është potencial, kur kësaj i shtohet edhe mungesa e ujit në regjionin e mbivades si e quejmë ne por jo vetëm dhe kërkesat e shumta për furnizim me uj, e që në të kaluerën e kemi bërë me zjarrëfikës të cilët janë në ndrrim, këtë vit duhet menduar dhe kërkuar një zgjidhje tjeter ose të angazhohet staf si punë shtesë në kohën e lirë të tij

			<p>ose të ngarkohet institucion tjetër. Numri i kufizuar i Zjarrëfikësve nuk është problem vetëm i Istogut por i Krejt Kosovës anadaj në takimin e OSBES-së në Pejë Drejtoresha e Emergjencave e Prizrenit e ngrit si çeshtje me që ish-in të Pranishim zyrtar nga MPB-ja edhe pse jo nga AME-ja, por me kërkesë që tju transmetohet ky shqetsim i Komunave.</p> <p>Zenun Bujupaj, Komuniteti Shqipëtar – pikrisht këtu ishte fokusimi i pyetjes sime tek vrojtimi-parandalimi dhe lajmrimi i hershem, a do të thot se po egzistojka ky sherbim. Është e rëndësishme që qytetarët të shohin se po egzistojka ky sherbim dhe kanë tjetër qasje kur janë të vetëdijshem se këta zyrtar janë prezent.</p> <p>Haki Belaj, inspektor i parandalimit - Agjencioni Pyjor e ka Planin e Menaxhimit të Pyjeve, e n kuader të saj edhe Planin e mbrojtjes nga zjarret. Aktivizimi i hershëm i ketyre Planeve është i domosdoshem dhe është preventiv dhe sukses i reagimit. Do të ket vizita sbashku me Policin dhe Agjencionin e Pylltaris në senzibilizimin e opinjonit dhe ne si Drejtori kemi shpall edhe njoftime në mediat lokale.</p> <p>Rifat Dreshaj, Agjencioni i Pyjeve të Kosovës – sa i perket monitorimit, pylltarët janë 24orë në teren dhe kemi hapsir për parandalim, sidomos vikendeve kur ka fluks më të madhë të vizitorve. Në rastë të zjarreve ne tentojm të ndermarim masa dhe të ndalim zjarrin mirpo nese është i permasave të mëdha ne e lajmrojm rastin sepse nuk kemi kapacitete.</p>
3	Konsumimi i drogave, tabaqqeve dhe alkoolit nëpër shkolla-teritorin e Komunës	Raport i Policisë, OJQ “ Labirinti” Ftohen Kryetarët e këshillave të nxënësve dhe prindërve	<p>Safet Blakaj, Drejtor i OJQ “ Labirinti- Drogat janë të ndryshme por ajo që është më e perhapura në teritorin e Kosovës është Marihuana. Sipas statistikave në Kosovë edhe pse mund të konstatojm se nuk janë 100% të sakta por keto i disponojm në Kosovë janë rreth 42.000 perdorues të drogave. Ne i ndajm në dy grupe dhe atë: perdorues të drogave, kjo kategori janë perdorues të kohëpaskoshme, pra jo të rregullt dhe kategoria e dytë; perdorues problematik dhe në këtë kategori kemi 12-14.000 pra kjo kategori janë perdorues të mvarur nga drogat të cilët bien ndesh me Ligjin, konflikt me familjen dhe rrethin shoqëror. Moshë mesatare e perdoruesve ka qen 35-45 vjet ndersa nga viti i kaluar kjo mesatare ka rënë 25-27 vjet. Mvarsia nga droga është tejet e shpejt dhe po që së nuk zbulohet në stazat fillestare të perdorimit atëhere mvarsia bëhet problematike dhe kryesisht</p>

këta përdorin tipin e drogës Kokain. Kjo është droga më e shtrëjt deri me tani.

Natyrisht se ne bëjmë ndarjen në regjione dhe këtu prindë Regjioni i Prishtinës, natyrisht për shkak të dinamikave të zhvillimeve në Kryeqytet. Përpara ka qënë Gjilani si regjioni i dytë për kah përdoruesit tani si regjion i dytë është Ferizaji ndërsa Gjilani ka rënë në vendin e tretë, e pasuar nga Mitrovica ku hyjnë edhe përdoruesit nga Mitrovica e Veriut dhe veriu në përgjithësi. Ajo çfarë është fokusi i këtij takimi është Regjioni i Pejës. Sipas statistikave Peja ka numrin më të vogël të përdoruesve, megjithatë ne kemi të dhëna të besueshme nga terreni që tregojnë tjerë shifra në krahasim me statistikat, por serish janë më të ulta se në regjionet tjera, megjithatë këto të dhëna tregojnë se po ndodhë diçka e keqe edhe në Regjionin e Pejës.

Kur e analizojmë Regjionin e Pejës tani na intereson ku qëndron Komuna e Istogut dhe ta bëjmë një krahasim të Komunës me Komunitat në tërë Kosovën. Istogu dhe Dragashi janë dy komunitet që kanë numrin më të vogël të përdoruesve të drogave në Kosovë. Nëse e krahasojmë Istogun me Lipjanin si dy Komuna periferishtë të madhësisë së njëjtë, na del se Lipjani ka numër shumë më të madhë të përdoruesve dhe kjo për arsye që Lipjani graviton më afër Kryeqytetit dhe kjo ka ndikim në përhapje më të shpejtë. Para dy viteve kemi vërejtur një dukuri të çuditshme përhapjen me shpejtësi enorme tek Komunitetet RAE në Fushë Kosovë, Gjilan, Prizren etj, që na bënë me dije që nuk janë më vetëm shtresat e pasura fokus i shpërndarësve të drogave.

Në Istog i kemi disa raste të përdoruesve të Kokainës, kur këto raste i krahasojmë me komunitet tjera nuk paraqesin shqetësim si statistik edhe pse dëshira është të ketë zero përdorues të drogave. Fokusi jonë kryesor është në parandalimin e përdorimit të drogave, jemi në përjekje të vazhdueshme që së bashku me strukturat Nacionale të hartojmë strategji dhe sisteme të parandalimit të përdorimit të drogave, shpresojmë që së shpejti të arrijmë deri te ky program. Në këtë aspekt gjithnjë fokusi ynë është siguria në Shkollë. Para 15 viteve moshën mesatare e fillimit apo përdorimit për herë të parë të drogës ka qënë mbi 21 vjet. Tani kjo moshë ka rënë në 16 vjet, në disa raste ekstreme kemi numër të vogël edhe me 12 apo 13 vjet por janë raste simbolike. Rreziku më i madhë tani është nga moshën 15-17 vjet dhe fokusi

jonë është kjo grupmosh. Kur flasim për këtë grupmosh domosdoshmërisht permendet Shkolla me që kjo kategori janë ende në Shkolla, por bërdomimi bëhet edhe jashta Shkollave dhe gjithnjë shtrohet pyetja pse spo ndermarrim diçka në Shkolla. Synimi është që ti pergatisim Psikologët e Shkollave, zyrtar në QPS-të që të mbahen ligjerata neper shkolla dhe të jen më të pergatitun që nga afer të vrejndryshimet dhe zbulimet e hershme eventuale apo si e quejm ne profesionalisht “ Identifikimi i hershem i perdoruesit të droges” gjë që mundson marrjen e masave në sherimin e hershem që është ma i leht.

Identifikimi i vonshem i perdoruesit të drogave krijon veshtersi në marrjen e masave qofshin ato represive qofshin sheruese. Per fillim kaq jam i gatshem tju pergjigjem pyetjeve.

Enver Balaj, Kryesues i këshillit të prindërve të Arsimin në Komunë- pas identifikimit si e beni trajtimin e perdoruesve të drogave, a i dergoni në sherim apo cili është tretmani i më tujeshem. A organizoni ligjerata neper shkolla në këtë tem në nivel vendit.

Safet Blakaj, Drejtor i OJQ “ Labirinti- kur janë në pyetje moshat e reja gjegjesisht nxënës të Shkollave, faza fillestare është permes prindërve dhe QSP-së. Natyrisht se duhet të bëhet një vlersim për llojin e droges së perdorur, kohëzgjatjen e perdorimit dhe kjo nuk mund të arrihet vetem me vlersime psikologjike por kerkon edhe vlersime biologjike, në organizaten tonë nuk kemi trajtim terditor por vetem permes seancave. Nese nuk kan simptome psikologjike athere vie në shprehje vetem intervenimet mjeksore që të bëhet pastrimi i trupit, ndersa në raste të rënda mvarsie dhe problemeve psiqike ather duhet trajtimi hospitalor dhe kemi bashkpunim me qendrat psikologjike. Ndersa qëndrave per trajtim afatgjat ju ikin edhe vet pacientet gjegjesisht perdoruesit e drogave sepse edhe ata janë të vetëdijshëm se mund tia dalin edhe me metoda tjera. Edhe Evropa është duke ju ikur qendrave afatgjate të trajtimit sepse vet perdoruesit po ju ikin ketyre qendrave.

Ukë Dollci, perfaqses i Komuniteti Egjiptas- e permendet komunitetin RAE si perdorues në kohen e fundit pyetja a jënë qytetar të kthyer nga perendimi apo janë vendas nese mund ti quaj ashtu, a ndermerr Policia masa.

Safet Blakaj, Drejtor i OJQ “ Labirinti- një pjesë e tyre janë të kthyer nga vendet perëndimore, shqetsimi jonë kryesor është shembull numri i madh i perdoruesve në Fushë Kosovë dhe Plemetin që për një kohë shumë të shkurt ka marrë masën shqetsuese, sepse nuk kemi pritje që aty të ketë perdorues të Heroines për vetëm një vit e gjysëm 72 persona si perdorues të rregullt ka qenë tejet shqetsuese sikur të kishin qenë vetëm perdorues të Marihuanes edhe nuk do të ishte aq problem për neve. Sepse ky është komunitet tejet i vogël. Pjesa më e madhe e tyre janë kyq në programet tona, dikun 58 prej tyre janë në programet tona rehabilituese.

Zenun Bujupaj, Komuniteti Shqipëtar – prezantohet për të pranishmit, nuk e di a është kompetencë e juaja apo a kemi njohuri për kanale të furnizimit, a janë të identifikueshme grupe të organizuara trafikantësh, a mund të bëhet ndërprerja e këtyre kanaleve dhe pyetja e dytë a mund të bëhet kategorizimi i grupeve si shtresa shoqërore gjegjësisht të pasur të mesme apo të varfëra.

A ka Kosova kapacitete të mjaftueshme për trajtimin e perdoruesve të drogave për të rehabilituar, për të kthyer në bashkëpunëtor për parandalimin e përdorimit të drogës dhe a ka statistika për trendin a është në rritje apo si qendron gjendja.

Safet Blakaj, Drejtor i OJQ “ Labirinti- Trendi mvarret sipas llojit të Drogeve, ka vit që përdoret një lloj ndërsa tjetri vit është tjetra drogë, sidoqoft trendi i përgjithshëm është në rritje, bile në rritje të shpejtë dhe është shumë afër nivelit që të bëhet alarmante. Përdoruesit e Heroines i kemi nën vëzhgim dhe kontrollë, përdoruesit e marihuanes dhe kokaines nuk i dim dhe nuk i kemi në kontroll.

Sa i përket trajtimit po me trajtim merret Labirini, kemi Klinika private, qendra tjera rehabilitimi në komunitet dhe sa i përket rezultateve krejt mvarret nga programi që e ndërmerr çdo njëra nga këto qendra. Ndërsa sa i përket shtresave sociale, viteve të fundit gjithçka ka ndryshu, pa marrë parasysh shtresën sociale apo ekonomike tanimë të gjitha janë target grup. Edhe Familja funksionale apo mirë e organizuar një ditë e vren fëmijun si perdorues njëjtë si ato familjet më dobët të organizuara, e kur vjen çështja të trajtimit atëherë kemi lehtësi në trajtim tek familjet e mirë organizuara.

	Shitja/Blerja e Ushqimit të përditshëm, data të skaduara, prodhim i pa kontrolluar	Të ftohen në bashkëbisedim përfaqësues të AUK-mbrojtja e konsumatorit dhe inspeksioni i Istogut	<p>Nuk kemi has grupe të strukturuar të trafikantëve të drogave. Droga Heroina ka ardh nga Turqia në Ballkan dhe per Evrop, Kokaina dhe kanabisi janë më të shtrëjta dhe pak konsumohen tek ne, kryesisht janë vetem si rrug kaluese per Evrop. Pra janë kryesisht individ që trafikojn nga jashta dhe piksynim e kan Evropen. Çeshtja është sa janë këta trafikant të inkriminuar në rrjetet egzistuese në Evrop, sa ndikojn njëni të tjetri, unë nuk jamë njohës i mirë i fushës së siguris por këto janë njohurit tona.</p>
4			<p>Enver Dembogaj, Inspektor pran Agjencionit të Ushqimit dhe Veterines – Në kuader të zyrës regjionale veprojm dy sektore ai i Veterines dhe ai i Sanitaris me nga dy Inspektor që është numer tejet i vogel per ta mbuluar regjionin e Pejës.</p> <p>AUV ka per detyr krijimin e kushteve për ushqim të sigurt dhe për të permbushur këtë detyr AUV merr produkte ushqimore qoft në Dogan apo në markete dhe i bën analizat, a i plotsojn gjitha kriteret për treg. Këto i bën me kontrolla të rregullta apo bazuar në kerkesat dhe shqetsimet e konsumatorve në rate të veçanta. Kemi kryer inspektive në komunën e Istogut dhe ka raste kur kemi shqiptuar edhe denime në raste të skadimit të afateve të gjerave ushqimore. Mund të konstatojm se gjendja në pergjithësi në Istog është e mirë megjithatë për ta konsumuar në pergjithësi këtë tem është dashur të jet edhe Inspektori Sanitar prezent sepse është pergjegjësi e tij a ka ndonjë produkt i cili shitet jashtëligjshëm apo që biznesi nuk e ka të drejtën ta shesë në veçanti per lokalet në afersi të Shkollave. Tani do ta kemi një problem në organizim me që Inspektori Sanitar ka kaluar në kuader të Ministris së Shendetsisë.</p> <p>Xhavit Blakaj, Inspektor i Veterinës Istog- pës ditë në javë bëjm inspektive të rregullta në thetoret e licencuara, gjithashtu inspektimet i bëjm edhe në mishtore dhe në markete. Problem na paraqesin fshatrat për inspektive të rregullta a shesin produkte të mishit dhe a bëhet therja sipas Ligjit. Fillimisht kaqnga ana ime jamë i hapur për pyetje.</p> <p>Blerim Gerguri, KLSP-Gurakoc- ka qen një shqetsim medial lidhur me importin e mishit të pulës nga Brazili, a ka ndonjë informat lidhur me veprimet e AUV-ut per këtë çeshtje.</p>

5	5. Gjendja në institucione shëndetësore - ordianca mjekësore -raportet staf-patient -furnizimi me medikamente (serume kunder pickimit nga gjarpërinjt) etj.	Të ftohen në raport udhëheqësit e institucioneve shëndetësore dhe OJQve relavante	<p>Enver Dembogaj, Inspektor pran Agjencionit të Ushqimit dhe Veterines – janë marrë mostrat e ketij produkti dhe nuk ka figuruar me ndonjë problem për të cilin do të ndalohej konsumimi i ketij produkti. Kemi pas raste kur kemi ndaluar komplet importin për konsum.</p> <p>Naim Behluli, Drejtor i DKA-së- kerkoj që Inspektori sanitar ti inspektoj lokalitet dhe kiosqet në afërsi të Shkollave dhe të konstatoj a shiten produkte ushqimore jashta licences, a shiten cigare me copë dhe të na informoj lidhur me këtë shqetsim të prindërve të nxënësve.</p> <p>Enver Dembogaj, Inspektor pran Agjencionit të Ushqimit dhe Veterines –Planet janë që në kuader të AUV-së të pranohen Inspektor të sigurisë ushqimore dhe shpresojm që së shpejti të kryhet ky proces.</p> <p>Xhavit Blakaj, Inspektor i Veterinës Istog- ka pasur raste kur kemi dal në inspektim së bashku me inspektorin e tregut dhe i njëjti ka shqiptu edhe denime për parregullsit në biznesin e inspektuar. Por ka një seri çeshtjesh që nuk janë kompetenc e ketij Inspektori por të atij Sanitar.</p> <p>Ali Nimanaj, Nënkrjetar i Komunës – shihet qart nga diskutimet që një seri çeshtjesh janë të Inspektorit sanitar andaj për mbledhjen e radhes të ftohet Inspektori dhe të na jep pergjigje në shqetsimet e ngritura. Me që nuk ka më pyetje kalojm në piken e radhes të rendit të ditës.</p> <p>Skender Hasangjekaj, Sektori i Emergjencave-Koordinator i KKSb-së – Inspektorja sanitare që mbulon Komunen e Istogut është në pushim të lehonis dhe ky sektor ka kaluar në kuader të Ministris së Shëndetsisë nuk kemi arritur që ta sigurojm prezencen dhe raportimin për mbledhjen e muejtit Qershor andaj kjo pjes e raportimit është bart për mbledhjen e radhes.</p>
5	5. Gjendja në institucione shëndetësore - ordianca mjekësore -raportet staf-patient -furnizimi me medikamente (serume kunder pickimit nga gjarpërinjt) etj.	Të ftohen në raport udhëheqësit e institucioneve shëndetësore dhe OJQve relavante	<p>Dr. Zenel Shatri, Drejtor i Drejtoratit të Shëndetsisë- lidhur me temen mund të themi se gjendjen e kemi relativisht të mirë, marr parasysh edhe situaten në të cilen jemi aktualisht, me që për shkak të ndertimit të Objektivit të ri të QKMF-së kemi bër fuzionimin dhe shperdarjen e disa sherbimeve nëper QMF-të në Bashkësi Lokale. Emergjenca funksionon 24 orë pa ndërpre dhe kemi një ekip që ofron sherbime në ambulant dhe një ekip që oron sherbimet në teren. I kemi 4 QMF dhe 8 AMF (ambulanta), e teta është në Fsh. Ujë që tani është hapur. Duke pas parasysh edhe fluksin e bashkatdhetarve pritët të shtohet fluksi i pacientve me smundjet sezonale.</p>

Sa i perket raportit ndermjet stavit shendetsor është i mirë dhe të njëjtin mund ta konstatojm edhe raportin staf-pacient me disa vrejthe të vogla që nuk ndikojn ndjeshëm në këtë raport. Jemi të furnizuar me barnat nga lista esenciale në QKMF në veçanti atyre në Emergjenc, duke filluar nga Oksigjeni, antishok terapia, Insolina, maksi për Insolin, EKG-ja pastaj stafi mjekesor, gjithashtu Emergjencia është e furnizuar edhe me serumin antiviperik kunder kafshimit të gjarprit. Dhe mjete të nevojshme për lendime në komunikacion. Laboratori tani punon deri në oren 18.00, laborantet bajn analizat emergjente duke perfshir edhe hemogramin. Tani ekemi edhe nr. 194 në emergjenc i cili funksionon nga telefonia fikse dhe nga vala por jo edhe nga telefonia IPKO per momentin.

Jemi të mobilizuar per ofrimin e sherbimeve Emergjencia funksionon 24 orë, paradite i kemi dy ekiye mobile, një per raste emergjente dhe njëna që ofron sherbime shtepiake ndersa pas dite është vetem ekipi mobil emergjent. Mer qe jemi në fazen e ndertimit të objektit të ri në QMF Gurrakoc e kemi Gjinekologjin ku e kemi shtu edhe një sherbim papatectin i cili është jetik për identifikimin e hershem të kancerit të qafes së mitres, andaj ftoj që ta shfrytzojm këtë mundsi të gjithë.

Zenun Bujupaj, Komuniteti Shqipëtar – më pelqeu shum ekzistenca e ekipit mobil që viziton pacientet në shtepia, me që ka shum raste kur pacienti për arsye të ndryshme nuk mund të shkoj në QKMF. Qysh e vlersoni ju punën e këtij ekipi mobil a funksionon mirë, a e kuptova mirëa funksionon para dhe pas dite. Sa i perket egzistences së numrit emergjent do të ishte mirë që qytetarët të njoftohesh permes tv Fontanes apo mënyra tjera, me që unë se kamë ditë dhe po besoj se ka edhe qytetar tjer që nuk janë në dijeni.

Dr. Zenel Shatri, Drejtor i Drejtoratit të Shendetsisë- Ka dikun tre kater muëj që është në funksion, e kemi lajmru permes Tv Fontanes, Veb faqes të Komunes bile e kemi paraqit edhe situaten pse nuk funksionon nga telefonia IPKO.

Sa i perket funksionimit të ekipit mobil, vetë si ekspert dhe si mjek 50/50 jam i knaqun. Thirrjet nga njëhere janë të pa nevojshme. Kur shkon ekipi e gjen pacientin tuj pi çaj dhe i njëjti deklarohet mu ngrit tensioni dhe kesh shumë keq. Megjithatë qendrimi imë është më mirë është të intervenoj ekipi

			<p>sepse mund të ndodh krahasimi i rastit dhe intervenimi i vonshem mund të jet me fatalitet dhe nisur nga ky parim gjithnjë kërkoj që ekipi të del në lokacionin e kërkuar. Sa ju perket pergjigjeve në telefonata mund të ndodh që mos të lajmrohen sepse mund të jetë në intervenim duke dhën gjylyper apo fashim, apo infuzion sepse fluksi është i madhë në sezon.</p> <p>Deri me tani i kemi pas pës raste të kafshimeve të gjarprit edhe pse në njërin rast pacienti nuk ka qën i sigurt a e ka kafshu gjarpri apo jo, megjithate dhejia e serumit nuk është i dëmshëm. Kushtet e punes i kemi tejet të rana kur është i gjith ky fluks i pacientve dhe pacientet janë mësu shum pak i frekuentojn QMF-të edhe pse aty është mjeku dhe tekniku.</p>
6	Parkimi i automjeteve në trotuare-pjerrinat në trotuare, pengohet lëvizja e lirë e qytetërëve në veçanti personat me nevoja të veçanta	Të ftohën për bashkëbisedim nga drejtorja për urbanizëm dhe shërbime publike	<p>Abedin Kabashi, Drejtorit të Drejtoratit të Shërbimeve Publike- lidhur me kete pik të rendit të dites nuk është pergjigsi ekskluzive e Drejtorait për Shërbime Publike, me që janë të nderlidhura edhe Drejtorit tjera si Inspekcioni, Urbanizmi etj, por megjithate do te tentoj ta jap një sqarim per aq sa janë kompetencat tona. Vitin e kaluar i kemi ber rreth 160 parkingje ne Istog, Shesh, ne Rr. 2.Korriku dhe gjitha oborret e Shkollave gjatë sezonies verore, Kryetari ka marr vendim te hapen dyert dhe te shfrytzohen per parkingje me qe fluksi i bashkëatdhetarve është i madh andaj deshirojm të krijojm kushte me aq sa kemi mundsi. Sa ju perket pjerrinave para dy viteve kemi pas nje projekt dhe së bashku me HENDIKOS-in gjegjësishtë Lumditen jemi dal dhe kemi bër identifikimin e vendkalimeve dhe pjerrinave të nevojshme për krijimin e kushteve të levizjes së lirë të komunitetit me nevoja të veçanta. Këtë projekt e ka zbatuar Drejtoria për Mirëqënie Sociale. Vitin e ardhshëm do të ket edhe investime tjera me që janë bër disa investime në rrugë dhe trotuare.</p> <p>Kap. Enver Gashi, Komandant i St. Policisë Istog – Policia e ka në implementim Planin Operativ trotuaret e lira dhe besoj i keni vrejt një patrull të Policisë gjatë gjithë dites me biçikleta që per qellim kan lirin e trotuareve.</p> <p>Enver Balaj, Kryesues i këshillit të prindërve të Arsimit në Komunë- z. Komandant dhe z. Kabashi vetem në Istog kemi trotuare, nuk ka trotuare në drejtime tjera të fshatrave, a keni mendu të bëni trotuare edhe në këto pjesë.</p>

Abedin Kabashi, Drejtorit të Drejtoratit të Sherbimeve Publike- faleminderit z. Balaj, edhe në këto pjesë ka po i permend ti aty ku ka Shkolla janë të ndertuara trotuaret dhe në vazhdimi jemi duke ndertuar, me kalimin e kohës duke pas parasysh edhe mundsit buxhetore do tju vie radha edhe vendbanimeve tjera.

Skender Hasangjekaj, Koordinator i KKS-së – Drejtori e theksoj se nuk është pergjegjësi vetem e Drejtoratit për Sherbime Publike dhe unë në pergatitje të mbledhjes i kam dergu ftesat edhe dy Drejtorive tjera, dje kamë bisedu edhe me Inspektorin e Komunikacionit dhe e kam njoftu rreth temes por nuk kamë ndonjë pergjigje pse sot nuk ka ardhur. Ajo çfarë do të duhej të trajtohet me theks të veçant janë plotsimi i kushteve të trotuareve egzistuese apo të ndertuara ti plotsojn këto kushte për të verberit dhe per personat me karroca, por jo vetem sepse edhe nënat me kolica me foshne kan probleme në disa pjesë të trotuareve dhe udhkryqeve. Egzistojn kubza apo pllaka të veçanta për të verberit në veçanti që duhet vendos në trotuare e në veçanti në vendkalime të rrugve dhe në udhkryqe. Si duket duhet që të demonstrojm të gjith ne që kemi pergjegjisi në Planifikim dhe zbatim të projektit që të ungjemi në kolica dhe ta shofim njëher sa e veshtir është të lëvizim me karroc apo si i verbert në disa trotuare dhe vendkalime.

Lumditë Idrizaj, HENDIKOS- po Drejtori e theksoj se kemi qen sbashku në identifikimin e vendkalimeve, trotareve parkingjeve për persona me nevoja të veçanta por nuk po vrehet ndonjë ndryshim i madhë që athere. Disa her kam kerku nga Policia që të ndalojn parkimin e automjeteve në hapsiren dhe në hymjen tek objekti i HENDIKOS-it dhe Policia kalon aty pari dhe nuk reagojn, kur i kam pyet Polict a po pengon kjo vetur këtu në hymje mu kan pergjigj Jo ska problem mundesh me lanë dhe kur ju kam tregu se nuk është vetura ime por kjo po na pengon neve sepse nuk kemi mundsi të dalim nga objekti serish nuk kan ndermarr masa për ta larguar të njëjtin.

Kap. Enver Gashi, Komandant i St. Policisë Istog – disa her në këto takime ju kamë than që une jamë i gatshem tju pergjigjem ankesave tuaja. E nderuara Lumdit kerkoni nga unë dhe unë do ta dergoj patrolen ta liroj hyrjen. Nuk e di kush është aj zyrtar policor që ka pas siellje jo të mirë ndaj jushë.

7	Qent endacak, sulmi ndaj fëmijëve dhe personave të ndjeshëm	Të ftohet në raport nga Ministria e Bujqësis dhe DEMSH	<p>Lumditë Idrizaj, HENDIKOS- u keqkuptuamë komandant qytetarët janë siell keq duke thënë mos e ke pa prurë ti ketë vënd ktu e asht i jyti, jo zyrtar policor që janë siell keq por nuk kan ndermarr masa ndaj pronarve të automjeteve najt qysh merr masa psh. si kur e sheh automjetin para barnatores të ndalur.</p> <p>Kap. Enver Gashi, Komandant i St. Policisë Istog -- edhe ndaj qytetarve që kanë siellje të kqia duhet që të vini në Stacion dhe ta lëjmromi dhe ne do të ndermarrim masa konform Ligjit.</p>
		<p>Skender Hasangjekaj, koordinator i KKSb-së – shkaku i angazhimeve të Drejtorit, i njëjti më ka autorizuar mua që ta paraqes një raport lidhur me aktivitetet që i kemi ndermarr deri me tani. E kemi pergaitit tenderin bazuar në Ligjin që të bëjm trajtimin e qenve endacak. Në bisedat dhe ankesat që i paraqesin qytetarët e shofim se prishmeria e tyre është largimi i tersishem nga rruga. Mundsit tona të momentit janë trajtimi i tyre që do të thot sterilizimi dhe vaksinimi i tyre ndërsa në rastet kur janë të smur dhe paraqesin rrezik athere me injeksion vihet në gjumë. Pas sterilizimit dhe vaksinimit Operatori Ekonomik serish i lshon në vendin e orgjinës që do të thotë ti lëshoj aty ku i ka nxan. Jemi duke bër perpjekje që në bashkpunim me Komunat fqinj të dakordohemi për mundsit e perbashkëta per ngritje të strehimores e cila do të mundsonte largimin e tyre nga rruga. Nga java e ardhshme qytetarët mund ti adresojn shqetsimet në Dretorin e Emergjencave lidhur me këtë temë. Gjithashtu jemi në dijeni se Qeveria e Kosoves e cila tani është në detyr ka filluar me analiza dhe për hartimin e strategjis lidhur me qent endacak në nivel Kosoves.</p> <p>Enver Balaj, Kryesues i këshillit të prindërve të Arsimit në Komunë- Në qytetin e Istogut si dhe qytete tjera shofim qën të smur dhe të ngordhur të cilët mund të paraqesin pandemi andaj më mirë është të asgjesohen sesa të lihen të ngordhin vend e pa vend.</p> <p>Skender Hasangjekaj, koordinator i KKSb-së – Bazuar në Ligjin për mbrojtjen e kafshëve, qent e semur apo të rrezikshem OE “Veterina” ka të drejt që me eutanaziti ti vëj në gjumë (asgjesoj), ndersa sa i perket ngordhjeve gjat aksit rrugor, rruget magjistrale janë në kompetenc të</p>	

8	<p>E drejta për punë: -Puna në sektorin privat -Orari i punës -Kontratat e punës</p>	<p>Të ftohet për raport inspektorati i punës për të bashkëbiseduar me KKSB-në</p>	<p>Ministrit, andaj mendoj që kompania që e ka kontraten per mirmajtje verore-dimrore do të duhej ti trajtoj, ndersa në rrugët per të cilat është kompetenc Komuna kur kemi informata ne ndermarrim masa për largimin dhe groposjen e tyre.</p>
<p>Monika Curri, Koordinator e Inspektoratit Qendror të Punës-Pejë - pershendet të gjithë të pranishmit. Këtu e perfaqsoj Divizionin për Inspektime në rajonin e Pejës. Si Inspektorat kemi një fushveprimtari të gjër , me të cilat na obligojn shumë Ligje dhe atë. Ligji i Punës, Ligji për siguri në punë, Ligji për Inspektorati e punës, Ligji për Lehona, Ligji për siguri dhe shëndet në punë Ligji për të huajt dhe shumë Rregullore tjera bazuar në këto Ligje. Nga muaji prill jam ushtruese e detyres si udhëheqëse e këtij divizioni të cilen në të kaluaren e ka udhëheq aji dhe ka prezantuar raportet e vitit 2024 por që i njajti është me disa probleme shendetsore andaj unë kamë pergatit një rapor për inspektimet e kryera në Komunën e Istogut dhe kamë bër një krahasim të gjendjes me komunat tjera në regjion por kam marrë komunën e Klinës e cila ka perafersisht specifikat e njajta sikurse Istogu, me që Peja është qytet më i madh dhe ka specifika tjera, më shumë biznese më shumë të punsuar etj.</p> <p>Ligji për Inspektime i parasheh disa lloje të inspektimeve dhe atë Inspektimet e pa planifikuara, Inspektimet e Planifikuara, Inspektimet me ankesë, inspektimet me aksident në vendine punës dhe inspektimet e përbashkëta të cilat bëhen sbashku me zyrtar Komunal; Policin etj.</p> <p>Inspektime të Planifikuara në Komunën e Istogut gjatë kësaj periudhe të vitit 2025 deri me 31.07. janë realizuar 27 inspektime, ndersa në Komunën e Klines janë realizuar 24.</p> <p>Pa planifikuara janë kur Inspektorët dalin në teren dhe duke qarkulluar hasin si psh. Vendpunishtet e pa siguruara që kemi shumë në të gjitha Komunat dhe inspektorat kryejn inspektimin. Raste të tilla i kemi 15 në Istog, ndersa në Klinë 18.</p> <p>Aksidente në vendin e punës, me keqardhje i kemi pas 11 që janë shumë. Fatmirsisht janë aksidente të vogla pa pasoja për jetë, por inspektori e ka për</p>			

detyr edhe në këto raste të vogla të del në vendin e ngjarjes dhe ta kryej inspektimin për shkaqet dhe pasojat e aksidentit.

Inspektimet me ankesa, ku hiç ma larg se sot kam pas një ankesë për një Shkollë në Istog, propozimet për transfere. Tema kryesisht është e bazuar në sektorin privat, ndersa rastin konkret e kemi në institucionin Publik, megjithatë duhet ta kuptojmë edhe ne që të drejtat e punëtorit duhet respektu, mbas 10 viteve punë, punëdhënsi është i obliguar që punëtorit ti lëshoj kontrat të perhershme dhe transferi nuk mund të ndodh pa pelqimin e punëtorit. Po e theksoj këtë sepse kohën e fundit kemi shumë ankesa nga sektori i Arsimit.

Inspektimet e përbashkëta kemi hasë në mirkuptim dhe bashkëpunim me Komunitat. Kur niveli lokal ka has ndonjë parregullsi-problem në ndonjë ndermarrje ka kërkuar bashkëpunim qoft përmes telefonit apo emailit për inspektim të përbashkët me inspektor të punës apo zyrtar të ATK-së dhe sektorve tjer ku secili zyrtar veç e veç kërkon dokumentacionin nga fushveprimtaria e vetë. Komuna e Istogut ka ofru perkrabje dhe bashkëpunim më shumë se Komuna e Klinës dhe Deçanit. Më së shumti nga këto Inspektime kemi kryer në sektorin e nderitmtaris ku gjatë vitit 2025 fatkeqsisht kemi pas edhe raste me fatalitet. Në Istog i kemi kryer 23 inspektime ndersa në Klinë 20 të tilla. Në sektorin e prodhimit janë 17 Inspektime ndersa 9 në Klinë. Sektori i shëndetësis nuk kemi pas me që ka qenë përgjegjisi e nivelit qendror ndersa nga muejji Gusht ka kaluar në përgjegjësi të Divizionit tonë. Bujqësi i kemi 4 inspektime në Istog 2 raste në Klinë. Hotelieri i kemi 5 Inspektime ndersa 4 në Klinë. Inspektimet në sektorin e shërbimeve që nënkuptojnë jashtë sektorve të përmendura si psh kompanit e sigurimeve, floktari etj . Sektorin e Arsimit deri me tani i ka pas Prishtinapor nga muejji gusht një në kompetenca tonat. Eche pse nuk jemi idhëtar të gjobave, sidomos në inspektimin e parë i jepet vretjia dhe afati për plotsimin e tyre. Nga 22 gjoba i kemi shqiptu në Istog dhe Klinë mirëpo vlera ndryshon. Vlera e gjobave për Istogun është 29.850€, ndersa për Klinën 26.350€ pra periudha 7 mujorshe.

Problemet më të mëdhat i kemi me Kontratat e punës të cilat nuk i përfshijn të gjitha elementet e parapara për Kontrat në Ligjin e punës në nenin 11.

Rjedhimisht nga kjo kemi raste kur punëtori paraqet ankes tek ne por shprehet se nuk e dinë çka ka me punu sepse në kontrat nuk i parashihen detyrat as orari. Këtu i gjejmë fajtor edhe punëmarrsit sepse nuk e lexon fare kontratën por vetem e nënshkruan, ndersa punëdhënsi nuk e merrë në punë juristin që ti hartoj kontratat por këtë punë në shumicën e rasteve ja kryen kontabilisti. Orari i punës është i parapar me Ligj. Shumica e bizneseve të Istogut nuk e rrespektojnë orarin e punës, punëtori është i obliguar të punoj 40 orë në javë që nuk do të thotë se punëtori nukë mund të punoj më shumë se 40 orë por që duhet specifiku dhe duhet evidentu si orë shtesë dhe duhet paguar mvarsisht a është ditë pune vikend apo festë. Nukë është orari i punës që zakonisht e perdorin bizneset hapet 08.00- 23.00. Orari i punës i parapar me Ligj është kurë punëtori fillon dhe mbaron punën, nese punon më teper se 8 orë në ditë duhet një marrveshje e veçantë për këtë koh ku specifikohet edhe pagesa e veçantë. Shumica e gjobave të bizneseve në Komunën e Istogut nga shuma që e paraqita më heret janë si pasoj e mosë rrespektimit të orarit të punës dhe mos pagesa e orëve shtes të punëtorve. Bizneset nuk mbajnë evidenc për punën shtesë të punëtorve, tani disa biznese të mëdha kan filluar me sistemin e kartelave për hyrje dalje, por jo të gjitha bizneset e kanë këtë mundsi. Arsyetimi nuk kemi kompjuter apo nuk po punon kompjuteri nuk kalon më, biznesi mund ta mbaj edhe në fletore evidencen e orarit të punës të punëtorve ku evidentohen edhe orët shtesë.

Disa mangsi mund edhe të tolerohen por jo edhe rrezikshmeria e jetës së punëtorit që po ndodhin në ndertimtari. Objekti dhjet kate pa skele pa siguri në punë, hiç ma larg se prapa Komunes ku ne po mbajm këtë mbledhje është objekti në ndertim, pa skele, pa masa mbrojtëse, pa parmak, asnjë punëtor nuk ta knaq syrin që ka paisje mbrojtse në punë. Ipen arsyetime se punëtori i pa shkollë i pa pergjegjëshëm, por ku është rrolli i punëdhënsit këtu, çfar masash ndermerr aji për zbatimin e masave mbrojtëse, sepse jo të gjithë punëtorët i ka të njëjtë pernga kfalifikimi.

Bizneset që i kemi inspektu në Komunën e Istogut janë: Beni, Shtepia G, Shkëmbi ku dje ka ndodhë një lëndim i lehtë, zakonisht informatat për lendime i marrim nga Policia dhe kemi dalë në inspektim në vendin e ngjarjes. Nga 27 rastet e inspektuara janë 11 lendime ndersa nga to janë 10

në ndertimtari si rezultat i mos ndermarjeve të masave mbrojtëse. Fillimisht në pika të shkurta ky do ishte raporti jamë e hapur për pyetje.

Enver Balaj, Kryesues i këshillit të prindërve të Arsimit në Komunë- tek sektori privat, gjegjësisht ndertimtari Ju apo Ministria e financave a mbajnë ndonjëhere fushata vetëdijesuese apo punëdhënsi si përdoret helmëta dhe paisjet tjera mbrojtëse.

Monika Curri, Koordinatorë e Inspektoratit Qendror të Punës-Pejë – Nga data 01.08-01.09.2025 e kemi një projekt të financuar nga ILO, kompani Suedeze dhe sot janë Inspektorët në Komunën e Istogut dhe në Komunën e Deçanit në këtë fushat vetëdijesuese. Kompania ka përgatit fletushka që janë shumë lehtë të kuptueshme edhe nese punëtori nuk dinë shkrim-lexim, fletushka është me foto që tregon punëtorit si dhe ku ta përdor helmëten, paisjet tjera mbrojtëse, si ta përdor shkallën etj. Duhet ta kuptoni se Inspektorati i Punës është institucion ekzekutiv. Konstaton shkeljen ndermerr masat, kesaj radhe kemi marr edhe rolin këshill dhënës dhe kemi lehtsu apo më mirë thënë kemi ndermjetsu per ta kryer projektin kompania në fjal dhe vetëdijesu punëtorët me qëllim zvoglimt të lendimeve në punë e në veçanti atyre me fatalitet.

Zenun Bujupaj, Komuniteti Shqipëtar – Do të fokusohem në dy çështje, gjë që besoj se shumicës i interesojnë. Tëk çështja e diskriminimit në punë dhe te siguria në punë. Ju e potencuet se nuk jeni adhures i gjobave, mendoj se nuk duhet kryer puna me emocione a me shkru apo mos me shkru gjoben. Inspektorit Ligji ja percakton veprimet dhe ato duhet ndermarr pa emocione, sepse punëdhënsi po e obligon punëtorin të punoj me orar të zgjatur dhe nuk e bën pagesen e orve shtes apo nuk i paguen sipas Ligjit. Andaj Inspektori ka per obligim ta zbatoj Ligjin. Ne kemi kontakte të perditshme me punëtorët dhe këto dukuri i verejm që ka diskriminim dhe shkelje Ligjore në veçanti kur është në pyetje orari i punës. Në këto dukuri sipas mendimit tim rolin kryesor e kan Inspektorati gjegjësisht Inspektori kur del në inspektim.

Monika Curri, Koordinatorë e Inspektoratit Qendror të Punës-Pejë – Po diskriminimi dhe siguria në punë janë përgjegjësi e Inspektoriatit por asnjë her pa e anashkalu edhe Gjykatën. Në Ligjin e punës janë disa nene që i parashohin edhe detyrat e Gjykatës ku Inspektori dergon lëndën dhe është

kompetenc e Gjykates marrja e Vendimit. Jo gjithëher mas ndeshkuese është Gjoba sepse ka raste kur Inspektori per mos zbatimin e masave mbrojtëse të punës merr masen për ndalimin e punës. Inspektori ja ndalon punën e qet shiritin objektit dhe shumica e bizneseve më shumë ankohen kur Inspektori ja ndalon punën dhe vendos shiritin sesa me gjobit me vler dhjet mi euro, sidomos tek objektet e ndertimtaris më shum i shkaktohet dëm punëkryesit me ndalim të punës sesa me gjobë monetare, prekja e shiritit gjegjësisht vazhdimi i punës pa i plotsuar kushtet e theksuara nga Inspektori është veper Penale. Pra Inspektori duhet dhën lejen për vazhdimin e punës. Masa e ndalimit të punës po ka efekt më të madhë sesa gjoba, sepse në pik të sezonit tja nderprersh punën një muej ka efekt të rënd tek ndermarrja.

Ali Nimanaj, Nënkryetar i Komunës – fillimisht falenderon znj. Curri për nj ëraport gjithëpërfshirës dhe krahasues me Komunat tjera. Qoft vetem edhe një gjob për mos plotsimin e kushteve për siguri në punë per ne është shqetsuese, sepse drejtpërdrejt ndikon në jeten e punëtorit. Pyetja ime është a ka Inspektoratinë Regjionin e Pejës staf të mjaftueshëm për me i mbulu dhe me i mbikqyr punimet në veçanti në sektorin e ndertimtarisë. Ndersa pyetja e dytë lidhet me sektorin Publik që e diskutut dhe Drejtori i Arsimit e ndriti doren për tu sqaruar lidhur me çeshitjen e ngritur për kontratat e punës.

Monika Curri, Koordinator e Inspektoratit Qendror të Punës-Pejë – Sa i perket numrit të inspektorve të punës në rajonin e Pejes, jo nuk kemi staf të mjaftueshëm, por është bër një ndyshim dhe tani janë sektore të ndara Inspektor për mardhanjë në punë dhe Inspektor për Siguri në punë, andaj është hapur konkursi për pranimin e gjashtë inspektorve për mardhanje në punë dhe një për siguri në punë me që aktualisht jemi shtatë të kualifikuar për siguri në punë, ndersa vetëm një për mardhënje në punë në Rajonin e Pejës. Nuk kemi informacion të sakt kur do të permyllet procesi i ketij konkursi. Inspektorët e siguris në punë do të merren më shumë me sektorin e ndertimit dhe ato ndermarrje ku cenohet siguria e punëtorit, ndersa Inspektort për mardhënje në punë do të merren me kontratat me orët shtes me raportet punëdhënës-punëmarrës. Me këtë rast kisha kerkuar një mirëkuptim në raste eventuale të vonesave sepse aktualisht jemi nuker i

vogel dhe besoni se më shumë punojn Inspektorët orë shtesë sesa punëtorët në sektorin e ndërtimit apo gastronomisë. Ka raste kur Inspektori nuk ka kohë as orën e pauzës ta shfrytëzojë. Ka raste kur p.sh. Komuna e Istogut Planifikon inspektime të përbashkëta në ora 20.00 në një sektor dhe Inspektori duhet të përgjigjet këty inspektimi të planifikuar. Ligji e parasheh afatin 30 ditë për kryerjen e një lande dhe në raste kur kërkohet dokumentacin shtesë me njoftim të palës shkon edhe në 45 ditë.

Nese ka të bëjë me 10 vjeçarin e kontratave bazuar në Ligjin e punës keni gabu, nuk jamë në dijeni për Legjislacionin e Arsimit që mund të ketë pika specifike, përpo edhe mardhanjet e brendshme, Udhzimet Administrative, Rregulloret apo Legjislacioni i Arsimit nuk mund të bë ndesh me Ligjin e Punës. Pra Rregulloret duhet të jenë konform Ligjit të Punës.

Naim Behlulaj, Drejtor i Drejtoratit për Arsim- falenderon Inspektoren në prezantimin e detajuar dhe jemi për mosshkputjen e kontratave por Ligji dhe Kushtetuta nuk lejon të japesh pag pa punë, ndersa Ligji i Arsimit mësimdhënsin e lidhë me numrin e nxënësve, pra ne nuk kemi baz Ligjore që mësimdhënsit ti vazhdojm kontraten kur i njëjti nuk ka nxënës.

Ligji i Arsimit parauniversitar i ka disa specifika që realisht bje ndesh me Ligjin e Punës. Ligji i punës thot të gjithë punëtorve që kanë 10vite pervoj pune i lëshohet kontrata me afat të pacaktuar, ndersa Ligji i Arsimit thot të gjithë mësimdhënsve që kanë 180 kredi u shpallet konkursi çdo vitë, nuk jamë i sigurt a theksohet në Ligjin e Punës, punë pa ndërpreje 10 vite. Në Istog i kemi tri raste të tilla dhe ju kemi drejtuar Inspektoratit të Arsimit për sqarime si të veprojmë këto raste, me qe Ligji i Arsimit parauniversitar është i qart për ne dhe është obligativ. Kemi mësimdhëns që nuk janë adekuat p.sh. Ka mësimdhëns që e ka të kryer Gjyhen Angleze por në Shkollë e jep gjubën Gjermane andaj të njëjtit çdo vitë duhet shpall konkursi. Bazuar në këto arsye do të ishte mirë që Inspektorati i Arsimit dhe Inspektorati i Punës të kemi takime të përbashkëta dhe të merret një vendim si të vazhdohet tutje.

Monika Curri, Koordinator e Inspektoratit Qendror të Punës-Pejë – Kontrata e perhershme nuk e theksova që nuk ki drejt ta shkputesh. Janë

procedurat vrejtie, paraprijashtim etj, pra mund të kryhen procedurat dhe me kete rast shkputet kontrata pas shkeljes të ranë që bën punëmarrësi.

Sa i perket shpalljeve të konkurseve këtë nuk e permenda, keni të drejt sipasLigjit të Arsimit, mirpo një punëtor që ka punuar 10 vjet shpallini konkurs por mos ja shkputni kontraten. Mund të mbajm edhe takim me Inspektoratin e Arsimit dhe të sqarohemi mirë rreth Legjislacionit dhe vendimeve në të ardhmën në mënyr që ne si Inspektorat i punës mos të kemi rëndin e gjatë të pritjeve nga mësimdhënësit, qoft nga Komuna e Istogut apo komuna tjera. Por duhet ta dini se Inspektoratet tonë e zbatojn Ligjin e Punës dhe Ligjin për Inspektoratin.

Naim Behlulaj, Drejtor i Drejtoratit për Arsimit- nuk e thash që nuk kemi të drejt të shkpusim Kontrat as kur është me kontrat të perhershme. Kemi afat 40 ditë ta njoftojm punëmarrsin për arsytet e shkputjes së kontrates. Nese nuk ka nxënës kemi arsy për shkputjen e kontrates, nese ka bër shkelje të rënd të Rregullores kemi arsy për shkputjen e kontrates, apo shkelja e Ligjit për Arsimin Parauniversitar. Kemi rastet kur punëtori ka edhe 11 vite punë por nuk është në drejtimin e duhur gjegjësishtë në drejtimin për të cilin është i kualifikuar dhe në këtë rast është obligative që çdo vitë ti hapet konkursi, andaj sipas Ligjit të Arsimit Parauniversitar nuk kemi mundsi të lidhim kontrat të perhershme. Të njëjtit ne i kemi sugjeru të lajmrohen tek ju sepse me shkresen ton janë paraqit në Inspektorat. Ju e keni lshu një Vendim dhe ne e kemi rrespektuar, por kur ata nuk janë të interesuar ti zgjidhin problemet dhe punët e veta unë nuk kamë baz Ligjore që tua zgjidh problemet sepse kamë obligim ta zbatoj Ligjin, andaj mendoj se Inspektorati i Arsimit sbashku me Inspektoratin e Punës mund ta gjeni zgjidhjen mes kundershtimeve të të dy Ligjeve.

Zenun Bujupaj, Komuniteti Shqipëtar- e kam pershtypjen se ka një keqkuptim ketu, demokracia është një lloj dhune e Ligjit, madje mund të jet definicion shum i sakt për demokracin. Ajo çfar do duhej të jetë thelbi është, nese ka diskriminim ose nuk ka siguri në punë Inspektoratet këtu janë autonom dhe duhet të ndermarrin masa. Nuk është e lejushme që punëdhënësi të bëj diskriminim të punëtorve dhe këtu duhet Inspektorati të nderhyj dhe të ndermarrin masa.

Ali Nimanaj, Nënkryetar i Komunës – mendoj se sqarimet që i dhanë Drejtori dhe Inspektorja janë të qarta dhe mendoj se të gjithë po pajtohemi por po i elaborojm me fjal të tjera. Ndergjegjsimi si i punëdhënsit si i punëmarrsit është proces në vazhdimsi dhe bazuar në statistika dhe raporte ka filluar të permirsohet, ketu ka ndikuar edhe Liberalizimi i vizave e që një numer i puntorve janë punësuar në perendim, andaj tek ne ka rën fuqia punëtore gjë që ka ndiku tek punëdhënsit per respektimin e të drejtave të punëtorve.

Skender Hasangjekaj, koordinator i KKS-së- falenderoj Inspektoren per nje raport të detajuar në krahasim me raportet e viteve të kaluara. Si tem ka qen e parapar me Planin e Punës bazuar në ankesat që i kanë paraqit kryesisht punëtorët nëper markete, për mos rrespektimin e kontratave dhe orarin e punës të stergjatur. Kjo tem është e rëndsisshme të debatohet në vijjimsi por mund të modifikohet edhe me sugjerimet e juaja me nëntemat për vitet në vijim. Më vije mirë që bashkëpunimi me Komunën e Istogut është më i mirë se me Komunat tjera në regjion.

Sa ju perket Inspektiveve të planifikuara a ka afat kohor kur parashtrohet kerkesa dhe a mendoni se KKS-së-ja mund të ju ndihmoj nese po në çfar forme.

Monika Curri, Koordinatorë e Inspektoratit Qendror të Punës-Pejë – Kohen nuk e kemi të parapar per parashtrimin e kerkeseve, por do të ishte mirë spaku një javë koh për të pas hapsir të nderhyhet në Planet e rregullia të Inspektorve dhe të caktohet termimi. Një Inspektim i perbashkët është realizu në kohë të shpejt në Fabriken e ujit Mokna, me që ka pas informacion se ka punëtor të huaj që po punojn aty dhe brenda dite është realizuar ky inspektim. Gjithashu janë objekt i inspektiveve të perbashkëta edhe kafet e natës e që në istog janë tri apo kater per të cilat zakonisht dy deri në tri ditë paraprakisht dakordohemi subjektet që marrin pjes në inspektim të perbashkët. Është shumë mirë që e bëre këtë pyetje andaj po ju sugjeroj që spaku një javë të parashtroni kerkesë për gjitha institucionet që marrin pjes në një inspektim të perbashkët, kur është fjala per inspektim të planifikuar.

9	Abuzimi me fëmijë minorë dhe adoleshent Bullizmi në Shkollë	Të ftohet në bashkëbisedim-raport përfaqësi i qendres për korrektim Përfaqësues të këshillit të nxënësve	Ali Nimanaj, Nënkrjetar i Komunës - Zyrtarja nga Sherbimi Sprovues pas konfirmimit për pjesëmarrje dhe ka derguar email tek Koordinatori dhe ka lajmruar se nuk mund të marr pjesë në takim dhe me keqardhje ka lajmruar se nuk ka mundësi të bëjnë zavendësime për të deleguar zyrtar tjetër, andaj pika e gjashhtë e rëndit të ditës shtyhet për takimin e radhes.
---	--	---	--

Sipas Planit Vjetor të punës KKSB-ja ka mbajtur 5 mbledhje në gjatë vitit 2025.

Nga 16 tema të parapara me Planin e Punës janë shqyrtuar 8 tema ndersa temat tjera nuk është arritur të shqyrtohen. Sikurse në pikën 9 që është paraqit në raport edhe pse është konfirmu pjesëmarrja nga raportuesja dhe është perfshi në rendin e dites serish zyrtarja ka munguar, poashtu ka ndodhur edhe me Inspektoren sanitare dhe kjo ka krijuar veshitirsi në permbushjen e Planit të punës.

Veshitirsi në organizimin –fillimin e punës ka paraqit mos pjesëmarrja e anëtarve në takime, andaj ka pasur vonesa në fillimin e takimeve duke i ftuar me telefon anëtarët për të siguruar kuorumin, gjë që ka krijuar vonesa në fillimin e takimit. Kjo ka ndodh kryesisht si fakt i mos pagesës të meditejeve të parapara me UA.

Tema tjera që janë diskutuar jashtë planit të punës e që kanë të bëjnë me sigurin janë:

- Janë shtruar kërkesa për intervenime në shënja të komunikacionit dhe në sigurinë në përgjithësi në komunikacion.
- Janë shtruar kërkesa për intervenime në trotuare dhe në ndriçim publik për siguri të nxënësve dhe qytetarve në veçanti komuniteti Boshnjak në Dobrushë.
- Nga komuniteti serb është ngritë shqetësimi për gërmimet në pronat private në Lubozhdë. Policia e Kosovës ka dhën sqarime se gërmimet janë bër sipas Planit nga Ministria në Zonën Arkeologjike Lubozhdë-Vrellë dhe se çdo gërmim që bëhet nese nuk ka gjetje, atëher prona, gjëgjësishtë vendi kthehet në gjendjen e më parshme dhe Policia ju ka dhën sqarime qytetarve të prekur nga ky veprim.
- Shqetsim janë deponit ilegale të mbeturinave edhe pse janë pastruar nga Drejtoria për Sherbime Publike, por sërish krijohen nga qytetarët
- Ndoftja e ambientit nga zjarret duke dhezur rrotoballa të kalbura apo goma
- Lënja e mbeturinave pas vetes në ditën e tregut pergat rruges
- Shqetsim ka qën prezenca e numrit të madhë të qënve endacak dhe sulmet ndaj qytetarve.

1. Siguria në zonën e përgjithëshme të Policisë së Kosovës-Stacioni Istog

- Situata në zonen e përgjegjësisë është e qet dhe stabile. Stacioni i Policisë vazhdon të punoj në bazë të Planeve Operative si dhe në bazë të Planeve dhe urdhërave nga niveli qendror dhe nga Komanda regjionale. Në vazhdim do të paraqes disa statistika në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.
- Raste të inicuar, kemi ngritje krahasuar me periudhen e njëjtë të vitit 2024
- vepra (kundervajtje dhe penale), kemi ngritje për 10 raste ma shumë
- Zbulueshmeria e 70.8% e rasteve në përgjithësi
- Aksidente trafiku, në krahasim me periudhen e njëjtë të vitit 2024, ka rritje 100%, që është shqetsuese
- Në fillim të mujeit kemi pas 1 tentim vrasje në Vrellë, në një ndermarrje kanë qenë 3 punëtor njëni nga ta është i arrestuar dhe është në arrest shtepiak për rastin vrasje në tentativ
- Sa ju perket urdhërësive nga Prokuroria apo Gjykata për ndalesa-arrestime aktive janë vetëm 4, për arsye se të kerkuarit gjinden jashtë shtetit
- Zbulueshmeria e rasteve në krahasim me të njëjtën kohë të vitit të kaluar është 76% që është shumë më e madhe
- Dhuna në familje kemi besueshmeri më të madhe në Polici dhe nuk hezitohet të paraqiten rastet
- Falë punës së Policisë në komunitet në Shkollë e kemi gjendjen shumë të mirë në krahasim me vitin e kaluar, kur ka të bëjë me veprat kryesisht që kryhen nga nxënësit
- kemi dy raste senzitive që do i paraqes ndersa per statistikat tjera në munges kohe do i paraqs në mbledhjen e radhes. Rasti i vetvrasjes të qytetarit nga Rumiku i Skenderajit që ka ndodh në Cerkoz, Policia në bashkëpunim me Prokurorin e rastit dhe mjekësin i ka kryer të gjitha egzaminimet dhe trupi i pajet është derguar në Institutin e Mjekësis Ligjore, rasti kalon në trajtim të mëtuajeshëm në Institucionet përgjegjëse. Rasti i zhdukjes të qytetarit Beqir Maloku. Në procesin e kerkim shpëtimit kanë qenë të kyqura njësia e kerkim shpëtimit nga FSK-ja, Policia e Kosovës me njësin K-9, Shoqata e kerkim shpëtimit "Kosova", Shoqata Alpinë, "Podguri, Kryetari i Komunes me bashkëpunëtor, Familjar të të zhdukurit. Zonat e dyshuara janë kerkuar edhe me dron dhe deri me tani nuk kemi rezultate. Rasti tani kalon në njësin Rajonale të hetimeve dhe do vazhdoj deri në gjetjen e personit të zhdukur.
- Është realizuar Plan Operativ në ndalimin e ndertimit të staneve në bjeshtë dhe atë kryesisht në Parkun Nacional me kërkes të nivelit Qendror.
- Statistikat e paraqitura nuk paraqesin faktin per gjithë vitin 2025, por per gjendjen janar-gusht 2025.

Pas raportimit në Kuvendin Komunal

Verteton Kryetari

Ilir Ferati

Koordinatori i KKSB-së
Skender Hasangjeka

